



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep. <u>DPKI</u>	Br Prot <u>06-02/1985/20</u>
Dep.	Prot No
Nr. i faq	Data
Broj stranica <u>03</u>	Datum <u>30.09.2020</u>
Nr. pages	Data
	Dati
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.09.2020, nxjerrë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-1108/20*, për zyrtarin e lartë publik z. Muhamedali Kodra, Anëtar i Bordit Drejtues në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për zyrtarin e lartë z. Muhamedali Kodra, Anëtar i Bordit Drejtues në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (tutje: FSSH), është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare e ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Kodra, krahas ushtrimit të funksionit si Anëtar i Bordit Drejtues në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, njëkohësisht ishte edhe përfaqësues i autorizuar në biznes privat. Gjithashtu, lidhur me zyrtarin në fjalë, Agjencia ka pranuar edhe një raportim nga një palë e jashtme e cila ka adresuar pyetjen se, a paraqet situatë të konfliktit të interesit fakti se z. Kodra, duke qenë Anëtar Bordi në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore njëkohësisht është edhe përfaqësues i Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve në Kosovë.

Në rastin e parë, për t'i vërtetuar dyshimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-1/516/20), është konstatuar se z. Kodra mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat O.S. "Metident".

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare (DPKI-06-1268/20), për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Kodra, Agjencia kundër Korrupsionit ka kontaktuar me të, me ç' rast e ka njoftuar për papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, konkretisht me atë se gjatë ushtrimit të funksionit si anëtar bordi në FSSH, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë është e ndaluar me nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje LPKI), i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”

Zyrtari i lartë z. Kodra, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit. Kështu që në ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-1268-1/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nënparagrafit 1.3. të LPKI-së, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, me çka është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërsa lidhur me pretendimet në rastin e dytë, Agjencia kundër Korrupsionit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se, të qenurit anëtar bordi në FSSH dhe njëkohësisht përfaqësues i Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve në Kosovë nuk paraqet konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së. Kjo për faktin se z. Kodra pozitën e anëtarit të bordit në FSSH e ushtron (ex officio), si përfaqësues i Shoqatave të Pacientëve ashtu siç përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, respektivisht neni 28, paragraf 3, i cili në mënyrë taksative ka përcaktuar përbërjen e bordit dhe atë:

3. Bordi Drejtues përbëhet nga tetë (8) anëtarë:
 - 3.1. Ministri i Shëndetësisë ose përfaqësuesi i tij;
 - 3.2. Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij;
 - 3.3. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale ose përfaqësuesi i tij;
 - 3.4. Kryetari ose Përfaqësuesi i Odës së profesionistëve shëndetësorë;
 - 3.5. Kryetari i Bordit ose Përfaqësuesi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës;
 - 3.6. Kryesuesi ose përfaqësuesi i drejtorateve të Shëndetësisë të Asociacionit të Komunave të Kosovës;
 - 3.7. përfaqësuesi i Shoqatave të Pacientëve;
 - 3.8. Drejtori i Fondit ose përfaqësuesi i tij, në rolin e Sekretarit të Bordit Drejtues, pa të drejtë vote.

Andaj nga sa u tha më lartë, u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.



II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip HAVOLLI
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

